



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË
KRYETARI

Nº 385 Prot.

Datë 24 / 07 / 2025

U R D H Ë R

Nr. 148 Datë 24.07.2025

“Për shpalljen e vendit vakant të pozicionit Drejtor i Drejtorisë së Projekteve pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”

Në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1966 “Për Kinematografinë” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.602 më datë 21.08.2003 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë” (i ndryshuar) dhe Kodit të Punës :


URDHËROJ:

1. Shpalljen e vendit vakant të punës për pozicionin ‘Drejtor i Drejtorisë së Projekteve’, pjesë e administratës së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë:
 - **Drejtor/e i Drejtorisë së Projekteve, kategoria e pagës II-2, një vend.**
2. Njoftimi i vendit të punës duke përfshirë kriteret, dokumentacionin dhe afatin e aplikimit, i bashkangjitet urdhrin dhe të shpallet në faqen zyrtare të internetit të QKK-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

JONID JORGJI



NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND PUNE VAKANT

Qendra Kombëtare e Kinematografisë shpall 1(një) vend vakant, në pozicionin e **Drejtor/e e Drejtorisë së Projekteve, me kategorinë e pagës II-2.**

Për këtë vend vakant, ftohen të aplikojnë kandidatët të cilët plotësojnë kriteret si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale;
5. Ndaj tij/saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil ose nga vendi i fundit i punës.

Kritere të posaçme:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta, Master Shkencor në një nga fushat: shkenca ekonomike ose shkenca sociale, me specializim në menaxhim projektesh;
2. Të ketë minimum 5 vite eksperiencë pune në menaxhimin e projekteve kulturore ose audiovizuale, nga të cilat të paktën 2 vite në rol drejtues;
3. Të ketë eksperiencë në hartimin, zbatimin dhe raportimin e projekteve kombëtare ose ndërkombëtare të financuara nga programe si Creative Europe, MEDIA, IPA, etj.
4. Të ketë aftësi të shkëlqyera në menaxhimin e projekteve në të gjitha fazat: hartim, implementim dhe monitorim;
5. Të ketë njohuri të avancuara të legjislacionit kulturor dhe skemave të financimit të filmit kombëtare dhe ndërkombëtare;
6. Të ketë aftësi për të hartuar strategji zhvillimi, si dhe për të monitoruar dhe vlerësuar ndikimin e projekteve;
7. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, në të shkruar dhe të folur.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidati aplikant duhet të dorëzojë këto dokumente:

1. Jetëshkrimin e plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në link-un: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
2. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë së Shqipërisë të përcillet detyrimisht njësimi nga Ministria përgjegjëse për Arsimin;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Dëshmi penaliteti;
7. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e aplikantit.

Dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet me e-mail, në adresën **info@qkk.gov.al** . Afati i fundit i aplikimit është 31 korrik 2025, ora 14:00.

Intervista me kandidatët e përzgjedhur nga dosjet e aplikimit, do të zhvillohet pranë ambienteve të QKK-së më datë 1 gusht 2025, ora 10:00 .

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.

Kandidatët do të intervistohen në lidhje me njohuritë:

1. Mbi ligjin nr.8096 datë 21.03.1966 “Për Kinematografinë”, i ndryshuar;
2. Mbi Konventën Europiane të Bashkëprodhimeve Kinematografike;
3. Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
4. Mbi ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
5. Si dhe në lidhje me motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

KRYETARI
JONID JORGJI